

**Pasqyrat financiare
dhe Shënimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Optima Communication Sh.p.k**

OPTIMA COMMUNICATION Sh.P.K.
NUIS K71903025A
Rruga Vaso Pasha, P. 2, Shk. 2, Ap. 7/1, Kati 2-të
PASQYRA FINANCIARE 2021

PËRMBAJTJA

	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E KAPITALIT	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-18
PASQYRA STATISTIKORE	19-20



Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,747,093	3,306,542
Kërkesa për arkëtim tregtare	5	2,626,326	3,361,116
Kërkesa për arkëtim tatimore	6	811,795	496,429
Inventarë	7	4,532,836	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	300,000	300,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		12,018,050	17,453,009
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	876,790	603,369
Të tjera kërkesa për arkëtim	10	7,988,920	9,988,922
Totali i aktiveve afatgjata		8,865,710	603,369
Totali i aktiveve		20,883,760	18,056,378
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	1,673,809	61,381
Detyrime Tatimore	12	5,487	502,562
Të tjera detyrime	13	497,012	229,029
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,176,308	792,972
Detyrimet afatgjata			
Detyrime financiare – afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	14	100,000	100,000
Rezerva ligjore, statutore	14	1,000,000	1,000,000
Fitim /(Humbje) të mbartura	14	16,163,406	15,929,447
Fitim /(Humbje) e vitit	14	1,444,046	233,959
Totali i kapitalit		18,707,452	17,263,406
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		20,883,760	18,056,378

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.
3

Pasqyra e performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
I. Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	12,836,233	10,314,667
Të ardhura të tjera	15	9,695	-
Total të Ardhurat (I)		12,845,928	10,314,667
II. Shpenzime			
Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara	16	(7,833,415)	(7,037,423)
Shpenzime të personelit	17	(2,849,310)	(1,915,792)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	18	(415,531)	(803,217)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	9	(134,988)	(170,214)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	18	(82,649)	(70,334)
Total shpenzimet		(11,315,893)	(9,996,980)
Fitim Humbja nga veprimtarite kryesore (I+II)		1,530,035	317,687
III. Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	19	(1,498)	(71)
Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit	19	(31,642)	7,644
Komisione Banke	19	(52,849)	(40,071)
Të ardhura (shpenzime) financiare neto (III)		(85,989)	(32,498)
Fitimi para tatimit (I+II+III)		1,444,046	285,189
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	20	-	(51,230)
Fitimi (Humbja) e Vitit		1,444,046	233,959
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat e këmbimit në përkthimin e operacioneve të huaja		-	-
Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës		-	-
Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve		-	-
Të ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Fitim/(humbje) i atribueshem për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		1,444,046	233,959
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Fitimi/(humbja) për vitin		1,444,046	233,959
Të ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		1,444,046	233,959
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		1,444,046	233,959

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Kapitali i regjistruar	Reserva ligjore	Fitime të mbajtura	TOTAL
Balanca e hapjes				
Më 01 Janar 2019	100,000		16,777,151	16,877,151
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-		233,959	233,959
Shtim Kapitali	-		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	100,000		17,011,110	17,111,110
Transferim ne reserve	-		-	-
Dividente të paguar	-		-	-
Më 31 Dhjetor 2019	100,000		17,011,110	17,111,110
Më 01 Janar 2020	100,000		16,929,447	17,029,447
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-		233,959	233,959
Shtim Kapitali	-		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	100,000		17,163,406	17,263,406
Transferim ne reserve	-	1,000,000	(1,000,000)	-
Dividente të paguar	-		-	-
Më 31 Dhjetor 2020	100,000	1,000,000	16,163,406	17,263,406
Më 01 Janar 2021	100,000	1,000,000	16,163,406	17,263,406
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-		1,444,046	1,444,046
Shtim Kapitali	-		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	100,000	1,000,000	17,607,452	18,707,452
Transferim ne reserve	-		-	-
Dividente të paguar	-		-	-
Më 31 Dhjetor 2021	100,000	1,000,000	17,607,452	18,707,452

Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:		
Fitimi pas tatimit	1,444,046	233,959
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	134,988	170,214
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>	1,579,034	404,173
Zvogëlimi / (ritja) e inventarëve	(4,532,836)	-
Zvogëlimi / (ritja) e kërkesave për arkëtim	2,419,426	972,823
Zvogëlimi / (ritja) e kërkesave për parapagime	-	720,576
(Zvogëlimi) / ritja e llogarive të pagueshme	1,383,336	(648,517)
	848,960	1,449,055
Interes i arkëtuar	-	-
Tatim fitimi i paguar	-	-
Paraja neto nga aktivitetet operative (I)	848,960	1,449,055
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(408,409)	-
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Paraja neto nga aktivitetet investuese	(408,409)	-
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:		
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	-	-
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	-	-
Arkëtime nga përdorimi i kredisë kufi	-	-
Paraja neto veprimtaritë financuese	-	-
Pakësimi neto i mjeteve monetare	440,551	1,449,055
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	3,306,542	1,857,487
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	3,747,093	3,306,542

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Administrator
Elton Rama

Elton Rama



Hartuesi i pasqyrave financiare

Oljona Kocaj



1. Informacion i përgjithshëm

Optima Communication sh.p.k. (referuar si “Optima” ose “Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 26 dhjetor 2006.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve grafike dizënjim, editori, dizënjim faqe web, grafike multimediale, fushata promovionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafike dizënjim. Shoqëria zotërohet 80 % nga ortak Z. Elton Rama, dhe 20 % nga ortak Z. Niko Qirici.

Vlera e kapitalit themeltar është 100,000 Lekë, e ndarë në 2 kuota me vlerë nominale respektivisht 80,000 lekë, 20,000 lekë për kuotë. Administrator i Shoqërisë është Z. Elton Rama. Shoqëria disponon ambjente në Tiranë që ndodhen në Rruga Vaso Pasha, P. 2, Shk. 2, Ap. 7/1, Kati 2-të, Tiranë, Shqipëri.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 7 (shtatë).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj.) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/Lek	120.76	123.7
USD/Lek	106.54	100.84



3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua me interes të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiare klasifikohen si asete afashkurtra me përjashtim të rasteve kur Shoqëria ka një të drejtë pa kusht për ta shtyrë pagesën e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës së interesit e cila i përafrohet normës së tregut.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Metodën dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje Informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti e të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Aktive afatgjata jomateriale	Lineare	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjesëtim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfutur njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Administrator

Elton Rama

Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari rrjedhëse dhe arkë:		
Leke	3,394,811	3,304,886
Euro	352,282	1,656
TOTALI	3,747,093	3,306,542

5. KËRKESA PËR ARKËTIM TREGTARE

Kërkesat e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë	2,626,326	3,361,116
TOTALI	2,626,326	3,361,116

6. KËRKESA PËR ARKËTIM TATIMORE

Kërkesat e arkëtueshme tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tatim - fitimi	496,429	496,429
TVSH	315,366	-
TOTALI	811,795	496,429

7. INVENTARË

Shoqëria ka inventarë gjëndje më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mallra për rishitje	4,532,836	-
TOTALI	4,532,836	-

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Parapagime të dhëna	300,000	300,000
TOTALI	300,000	300,000

9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

	Pajisje zyre, moblie	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali i Aktiveve Fikse
AQT me kosto historike				
Teprica më 1 Janar, 2021	1,162,652	3,083,199	1,157,436	5,403,287
Shtesa nga blerjet	48,583	359,826	-	408,409
Pakësime nga shitjet	-	-	-	-
Teprica më 31 Dhjetor, 2021	1,211,235	3,443,025	1,157,436	5,811,696
Amortizimi akumuluar				
Teprica më 1 Janar, 2021	(1,027,681)	(2,811,010)	(961,227)	(4,799,918)
Shtesa e vitit	(34,939)	(60,807)	(39,242)	(134,988)
Pakësime të vitit	-	-	-	-
Teprica më 31 Dhjetor, 2021	(1,062,620)	(2,871,817)	(1,000,469)	(4,934,906)
Balanca më 31 Dhjetor, 2021	148,615	571,208	156,967	876,790

10. KËRKESAT E TJERA PËR ARKËTIM

Kërkesat e tjera për arkëtim më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kërkesa të tjera për arkëtim	7,988,920	9,988,922
TOTALI	7,988,920	9,988,922

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Furnitorë	1,673,809	55,200
Furnitorë për fatura të pambërritura	-	6,181
TOTALI	1,673,809	61,381

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tatim mbi të ardhurat personale	1,624	10,746
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,863	12,200
TVSH	-	479,616
TOTALI	5,487	502,562

13. TË TJERA DETYRIME

Teprica e zerit të tjera detyrime më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhet si më poshtë:

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga dhe shpërblime	497,012	229,029
TOTALI	497,012	229,029

14. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kapitali	100,000	100,000
TOTALI	100,000	100,000

Shoqëria ka kaluar në zërin reserva ligjore/statutore shumën prej 1,000,000 Lek.

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga shërbimi	8,227,275	10,314,667
Të ardhura nga shitje e mallrave	4,608,958	-
Të ardhura të tjera	9,695	-
TOTALI	12,845,928	10,314,667

16. SHPENZIME DIREKTE PËR MALLRAT DHE SHËRBIMET E REALIZUARA

Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shërbime prodhimi/konsulence	1,216,614	2,120,095
Shërbime design	244,980	1,217,243
Shërbim realizim portali	-	333,380
Realizim video	700,000	3,366,705
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	5,671,821	-
TOTALI	7,833,415	7,037,423

17. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Pagat e personelit	2,637,423	1,763,019
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	211,887	152,773
TOTALI	2,849,310	1,915,792

18. SHPENZIME TË PERGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzim certifikimi	61,000	-
Shërbime mirëmbajtje dhe sigurimi	66,738	-
Shërbime konsulence marketing	-	501,162
Shpenzime kancelarike	40,138	-
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	161,875	148,426
Shërbime qira	73,461	61,962
Shërbime konsulence financiare	12,319	-
Shërbime auditmi	-	91,667
Shpenzime të tjera	82,649	70,334
TOTALI	498,180	873,551

19. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesa bankare	-	8
Shpenzime për interesa	(1,498)	(79)
	(1,498)	(71)
Fitime të realizuara nga kursi këmbimit	3,379	43,792
Humbje të realizuara nga kursi këmbimit	(35,021)	(36,148)
	(31,642)	7,644
Komisione bankare	(52,849)	(40,071)
TOTALI	(85,989)	(32,498)

20. TATIM FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit,

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi (humbja) e vitit	1,444,047	285,189
Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:	4,300	739,410
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	1,448,347	1,024,599
Shpenzimi aktual për tatim fitim	-	(51,230)
Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto	1,448,347	973,369
Gjendje kreditore e mbartur	496,429	547,659
Balanca TF për vitin pasardhës	496,429	496,429

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2021. (2020: 5%).


Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të adhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, Shoqëria nuk ka detyrim tatim fitimi për të paguar, si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tatim-fitimi	-	51,230
TOTALI	-	51,230

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 25 Mars 2022.

Administrator
Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***Shoqëria Optima Communication Sh.p.k.****NIPT K71903025A****Aktivët Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2021**

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2021
1	Toka				
2	Ndërtime				
3	Makinëri,paisje Instalime				
4	Mjete transporti	1,157,436			1,157,436
5	Mobilje Orendi	1,162,652	48,583		1,211,235
6	Paisje Infomatike	3,083,199	359,826		3,443,025
TOTALI		5,403,287	408,409	-	5,811,696

Amortizimi A.A.Materiale 2021

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2021
1	Toka				
2	Ndërtime				
3	Makinëri,paisje Instalime				
4	Mjete transporti	961,227	39,242		1000469
5	Mobilje Orendi	1,027,681	60,807		1,088,488
6	Paisje Infomatike	2,811,010	34,939		2,845,949
TOTALI		4,799,918	134,988	-	4,934,906

Vlera Kontabël Neto e A.A.Materiale 2021

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2021
1	Toka				
2	Ndërtime				
3	Makinëri,paisje Instalime				
4	Mjete transporti	196,209	(39,242)		156,967
5	Mobilje Orendi	134,971	(12,224)		122,747
6	Paisje Infomatike	272,189	324,887		597,076
TOTALI		603,369	273,421	-	876,790

Administratori

Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Shoqëria Optima Communication Sh.p.k.

NIPT K71903025A

Inventari automjeteve në pronësi të subjektit

31.12.2021

Nr.	Lloji automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera e mbetur
1	Hyundai I10	4+1	AA738FP	156,967
Shuma				156,967

Administratori

Elton Rama

Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***Shoqëria Optima Communication Sh.p.k.**
NIPT K71903025A

Inventari në pronësi të subjektit

31.12.2021

Nr.	Lloji i mallit	Cope	Cmim	Vlera
1	Aksesore per dron	1	5,000	5,000
2	Biostar MboTB360-BTC Pro 2.0	1	13,884	13,884
3	CPU G5905	2	5,044	10,088
4	Dell NB Mobile Precision Workstation	2	140,963	281,926
5	Dron DJI Mavic 2	1	122,500	122,500
6	Frozen Tower A6	2	1,009	2,018
7	Gforce RTX 3090 Gaming X TRIO	5	146,483	732,413
8	Gforce RTX 3090 Ventus 24g	3	146,079	438,237
9	Gigabyte intel Z590 UD	2	5,044	10,088
10	GJENERATOR	1	155,000	155,000
11	Intel celeron G4930T	1	4,709	4,709
12	Laptop	1	15,417	15,417
13	Magnus PC	4	45,574	182,295
14	PCIE Riser 010S Plus	20	303	6,053
15	Printer Termik	1	7,688	7,688
16	PSU CM 700W	10	8,000	80,000
17	Colorful/Segotep Ram8gb	2	1,765	3,531
18	Monitor Dell E2222HS 21.5" + kabulla lidhes	1	18,015	18,015
19	Segotep PSU SG-1800W	2	7,264	14,527
20	SSD 120 GB	4	2,021	8,083
21	TV FUEGO LED 43EL610	1	88,750	88,750
22	VGA GTX 1050 Ti 4GB	12	15,500	186,000
23	VGA GTS 1650 4 GB	8	18,500	148,000
24	VGA RTS 2070	1	63,000	63,000
25	VGA ASUS RTX 3080	4	186,000	744,000
26	VGA Sapphire RX	14	14,000	196,000
27	Zotac Gaming Gforce RTX3090	5	135,508	677,542
28	Zotac Magnus One, Nvidia 3060	7	45,439	318,071
Shuma				4,532,836

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë, më 25 Mars 2022.Administrator
Elton Rama